



VELIPOJA

Velipoja ndodhet në Rajonin e Shkodrës, pranë kufijve me Malin e Zi. Zona ka rreth 8 km vijë bregdetare dhe përfshin Ishullin Franc Josef, që vazhdimisht ndryshon formë. Vija kufitare ndjek Bunen e poshtme. Fshati turistik i Velipojës, ndodhet 35 km nga qyteti i Shkodrës, është një qendër turistike mjaft e këndshme, me peisazh të larmishëm, ku ndërthuren hijshëm plazhi, lumi, delta me ishuj, kodra, fusha, laguna, pylli, liganatat. Ky përbën vendin më ideal për bird watching të zogjve të adriatikut Lindor në dunat e rërës dhe pellgjet e cekëta të ujit. Kjo zonë shquhet për tradita dhe histori të hershme, me fermerë dhe peshkatarë të zot, mikpritës të njohur në të gjithë Shqipërinë. Fshati bregdetar, plazhi i madh dhe qendra turistike shtrihen në jugperëndim të Shkodrës, në fushën e gjerë të Velipojës të lagur nga adriatiku, pranë kufirit me Malin e Zi, me të cilin e ndan lumi Buna dhe grykderdhja e tij. Relievi është tërësisht fushor, nga 1-3 metra mbi nivelin e detit deri në 550 m (maja e Zezë në kodrën e Rencit). Kjo ka sjellë formimin e kënetave dhe moçaleve të shumta.

Fshati Velipojë është qendra e komunës dhe përfshin 10 fshatra: Velipojë, Reç, Pulaj, Luarzë, Baks, Rrjoll, Gomsiqe, Boks i ri, Mal i Kolajve, Reç i ri.

Emri Velipojë vjen nga sllavishtja e vjetër (Velikopolje - fushë e madhe). Historikisht ka qënë zonë e dominuar nga fisi i vjetër katolik i Kastratit, që njihej me emrin fisi i pesë bajraktarëve.

Popullsia është tërësisht shqiptare, kryesisht katolikë.



RRUGA PËR NË VELIPOJË

Rruga Tiranë-Shkodër është 97 km e gjatë dhe kthesa për në Velipojë ndodhet 5 km para se të mbërrini në Urën e Bahçallëkut, në të majtë, aty lexon Harku i Bërdicës. Që nga rruga kryesore distanca për në Velipojë është 24 km.

Rruga nga Mali i Zi për në Shkodër kalon nga dogana e Muriqanit, 14 km, dhe hyrja në qytet bëhet nga Ura e Bunës. Në Muriqan ndodhet edhe një pikë shumë e rëndësishme pushimi dhe informacioni që është Kompleksi Çeliku. Nga Mali i Zi mund të vihet edhe nëpërmjet doganës së Hanit të Hotit, 35 km, pastaj përmes Bajzës e Koplikut, mund të vihet nga pjesa veriore e qytetit.

NATYRA

Zona bregdetare e Velipojës, e orientuar Perëndim-Lindje, karakterizohet nga një breg rëre. Ajo furnizohet nga Lumi i Bunës që lidh Liqenin e Shkodrës me detin, dhe mbulon rreth 694 ha.

Zona formohet nga sediment kuaternarë kryesisht me rërë të hollë në breg; bregdeti karakterizohet kryesisht nga aluvione lumenjsh.

Konfigurimi i vijës bregdetare dhe dunat nënujore mund të levizin shumë shpejt gjatë stuhive ose përmytjeve, më shumë në pranverë dhe vjeshtë. Shenja erozioni, të krijuara nga veprimi i dallgëve kryesisht mbi dunat ranore, mund të evidentohen pranë grykëderdhjes së Lumit Buna dhe në pjesën jugore të plazhit të Velipojës. Foka Mesdhetare (*Monachus monachus*) dhe delfinë janë vërejtur në grykëderdhjen e lumit Buna, çka tregon se ka gjasa që kjo të jetë zonë ushqimi.



Klima

Velipoja ka një klimë të butë (temperatura mesatare 6 - 7 C), vera është mjaft e nxehtë (temperatura mesatare e Korrikut, 24 C deri në 48 C maksimumi në perjudhën Korrik – Gusht) Periudha e përshtatshme për banjo dielli fillon në muajin qershor dhe vazhdon deri në fund të shtatorit. Për ato që janë më të përgatitur fizikisht, kjo periudhe zgjat nga fundi i prillit deri në fund të tetorit. Bien rreth 1400mm reshje në vit, kryesisht të përqendruara në gjysmën e dytë të vjeshtës, dhe dimrit.

Mjedisi ligatinor

Ligatina e Velipojës ndodhet në Grykëderdhjen e Lumit Buna, dhe përfshin katër moçale të cekëta. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së ujit është e mbuluar nga një shoqërim i Kallamishtes dhe Rogozës. Në thellesi më të madhe, mund gjendet gjithashtu një bashkim zambaqesh. Zona ligatinore përfshin një zonë pyjore, që përbëhet prej Frashër, Vidh, Shtog, Lis, Pishë Italiane, Shelg, Marinë, Mushmollë, Shkozë, Trëndafil, dhe pyje bregore Plepash të bardhë, Frashëri, dhe galeri Verrash të zinj, të ndarë nga plazhe rëre vegetative të medha të mbjella me lloje pishash. Ligatina është një strehë për shpendët migratorë të detit, dhe tërheq shumë specie zogjsh, të tilla si Kryekuqe, Rosa, Bajzat, Kredharak, Karabullaku, Cafka. Zona është gjithashtu një ambient i rëndësishëm ushqimi dhe migrimi për pelikanët Dalmate, që janë ndoshta pjesë e popullsisë të pelikanëve të Mali të Zi. Rugës për në Velipojë gjejmë gjithashtu kënetën e Domjes, e cila mbulohet në masën 60% nga Kallamishtet.

Mjedisi tokësor

Vegjetacioni kryesisht është formuar nga pyje nën-Mesdhetare të thatë gjethegjërë të Orno-Ostryetalia-s. Bregdeti pjesërisht është mbuluar nga pisha dhe vidhe të mbjella, dhe pjesërisht nga ligatinat. Ishulli Franc Jozef përfshihet në deltën joartificialisht të pyllëzuar të Bunës, që formohet nga moçale të vjetra bregore dhe laguna të njelmëta me disa plantacione plepash. Ishulli është formuar nga sedimente të grumbulluar i mbuluar me koriye. Një rezervat shkencor mbulon 60 ha, dhe është një zonë strehuese shumë e rëndësishme për Cafkat dhe Karabullakët. Dunat bregdetare midis lagunave dhe detit janë mbjellë me pemë pisha rreth 20 vjet më parë. Në brendësi, fusha e Karriqit është

bonifikuar nga moçalishte të shtrira gjërë; aktualisht është vetëm pjesërisht e shfrytëzuar, dhe shumica e fushave të abandonuara kullohen nga bagëti e lëvizshme.

Statusi aktual mbrojtje/ruajtje

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të Shkodrës është përgjegjëse për administrimin e zonës moçalore dhe pyjore të Velipojës. Me Vendim të Qeverisë Nr. 682, datë 2.11. 2005, zona e Lumit Buna, së bashku me grykëderdhjen e saj dhe Ishullin Franc Joseph, rezorti i Velipojës, laguna e Viluni, plazhi Boks-Rrjoll, Këneta Domni, sikundër dhe territoret përreth, janë përcaktuar si Territor Tokësor dhe Ujor i Mbrojtur.

Rezervati i manaxhuar i Velipojës

Ky rezervat (700 ha), shtrihet në deltën e lumit Buna, rreth 8 km larg nga Velipoja. Ai përbëhet nga pylli mjaft i dendur me pisha mesdhetare, vërrë, frashër, plep, shëlg shkurre mesdhetare etj. Ky rezervat është i pasur me ligatina me bimësi pyjore e shkurre, livadhe me bimësi barishtore të dendur. Në këtë pyll jetojnë kafshë të shumta të egra: lepuri, çakalli, derri i egër, fazani etj. Të shumtë janë shpendët migratorë dhe të përhershëm. Rezervati është një nga pozicionet më të bukura për pritjen e shpendëve migratorë për periudhën e dimrit të tilla si shapka, shapka e ujit, rosa dhe pata.

Delta e Bunës

Delta e Bunës, është krijuar nga depozitimet e këtij lumi, ka formën e një trekëndëshi të madh me bazë nga deti. Në të ndodhen dy ishuj të mëdhenj ADA (5 ha në Mal të Zi) dhe ishulli i Franc Jozefit, i krijuar nga depozitimet e aluvioneve të lumit, mbas mbytyes në 1881 të anijes austriake me të njëjtin emër nga flota ruse, që kishte ardhur për të detyruar shqiptarët t'i dorëzonin Ulqinin Malit të Zi, në zbatim të vendimeve famëkeqe të Kongresit të Berlinit për copëtimin e trojeve shqipare. Ky ishull dallohet për bimët dhe kafshët e rralla si druri i rrënjës, që është një lloj dushku alluvial tepër i rrallë dhe në rrezik në zhdukje. Delta e Bunës është afër 10 km nga qendra e Velipojës. Një udhëtim nga fshati i Velipojës dejt deltës së Bunës është mjaft i këshillueshëm për amatorët e shëtitjeve në natyrë.

Fshati Boks-Rrjoll

Fshati Boks-Rrjoll ndodhet në juglindje të Velipojës. Ky fshat përbën vlera dhe bukuri të panjohura. Shtrihet pranë detit dhe mali i Rrencit ngrihet thikë mbi të. Vizita në këtë fshat mund të bëhet me varkë nëpër lagunë apo me këmbë. Ky fshat është mjaft i njohur për traditat etnografike dhe folklorike. Plazhi i këtij fshati është i virgjër me rërë të pastër e ujë Kristal.

Duke ecur më tej, ndodhemi pranë rërës së hedhun, që përbën një masiv të rërës nga era në këmbët e kodrës gëlqerore të Rrencit. Nga Velipoja në rërën e hedhun rruga është 8 km, por e vështirë. Mund të udhëtohet vetëm me barkë.

Laguna e Vilunit

Laguna e Vilunit ndodhet 2 km në lindje të plazhit të Velipojës, ka një sipërfaqerreth 300 ha dhe një thellësi përgjithësisht 1-3 m. Dikur kjo lagunë është quajtur laguna e

Lundrëzës, sepse ka patur shumë lundra, një gjitar interesant që ushqehet me peshq. Kjo lagunë rrethohet nga ligatina, komunikon me detin përmes një kanali natyror, në të cilin për shkak të baticës dhe zbatës uji ndryshon drejtim çdo 6 orë. Ka ujë të kripur me temperaturë mesatare 20-22 C. Kjo lagunë është e pasur me peshq të llojeve të ndryshëm dhe mjaft të shijshëm. Këtu hasen rreth 200 lloje shpendësh, migratorë dhe të përhershëm.

AKOMODIMI

25000-35000 lekë të reja duhet të paguani nëse doni të qëndroni në Velipojë për një periudhë 10-15 ditore, në një dhomë apo apartament me qera. Shumica e strukturave ofrojnë pikërisht këtë mundësi masive. Por në pjesën më të madhe të këtyre garsonierave, mund të kërkoni edhe t'ju gatuajnë sipas dëshirës që keni dhe ju mund të paguani vakte me kosto të lirë ose mesatare, nëse nuk doni të humbisni kohën e vyer të pushimit me gatim. Është e këshillueshme që të informoheni qysh në fillim për çmimet dhe nëse “të zotët” e shtëpisë mund të gatuajnë për ju apo jo, nëse ju nuk do ta merrni vetë përsipër një gjë të tillë.

Velipoja ofron edhe strehim në hotele përgjithësisht komode që ju ofrojnë kushtet e nevojshme për pushime të rehatshme, duke filluar nga 30-35, deri në 60 euro nata, duke përfshirë mëngjesin, shërbimet e plazhit dhe parkingun. Gjithashtu shumica e tyre ofrojnë garsoniera ku ju mund të gatuani vetë ose të zgjidhni një opsion vaktesh ose gjysëm-vaktesh ku, kuptohet duhet të paguani një tarifë plus. Disa prej hoteleve e ofrojnë mundësinë full-board (të gjitha vaktet e përfshira) me 15-25 euro personi në ditë, sipas standarteve të hotelit.

Jeta e natës

Vitet e fundit Velipoja është bërë edhe qendër masive e argëtimit nokturn për shkak se një sërë klubesh, diskosh dhe lokalesh të tjera nate kanë hedhur rrënjët e tyre në plazh. Në diskot e shumta, jo vetëm që mund të kaloni orë të plota në shoqërinë e muzikës, por mund të shijoni edhe emra të njohur të muzikës shqiptare dhe botërore, që organizatorët i ftojnë jo pak herë për të performuar nëpër skenat e këtyre klubeve.

Për të marrë më shumë informacion rreth Velipojës, akomodimit në hotele, restoranteve e bareve, shiko:

www.velipoja.com

www.velipojaguide.com